

BASHKIA E TIRANËS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Gjoka Konstruksion” sha
Adresa: Njësia Nr. 5, Rruga “Dora D’Istria”, Hyrja 1 dhe Hyrja 2, Pasuria
me Nr. 7/637 + 1 – N5, 7/637 + 2 – N1, Z.K 8270.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikonstruksioni i segmentit të rrugës
Mushqeta-Krrabë”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksioni i segmentit të
rrugës Mushqeta-Krrabë”.

Fondi limit: 115,357,868 (njëqind e pesëmbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr.58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” si dhe VKB Nr. 26 datë 23.05.2016 ”Për një ndryshim në VKB Nr. 58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016 (i ndryshuar)”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 05.09.2016, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 32 datë 15.08.2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Alb Tiefbau” shpk

NUIS J66703049C

Vlera e ofertës = **71,857,517** (shtatëdhjetë e një milion e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk

NUIS J61812013R

Vlera e ofertës = **73,184,909.30** (shtatëdhjetë e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntë pikë tridhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Gjoka Konstruksion” sha

NUIS J91815014U

Vlera e ofertës = **85,133,640.6** (tetëdhjetë e pesë milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzetë pikë gjashtë) lekë pa TVSH.

**4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ndregjoni” shpk & “Vllaznia Ndërtimi I.S” shpk
NUIS K31329048I & NUIS K77524909Q**

Vlera e ofertës = **85,343,287** (tetëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzetë e tre mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Company Riviera 2008” shpk & “Dajti Park 2007” shpk

NUIS K81716011V & NUIS K11507003S

Vlera e ofertës = **86,164,812** (tetëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agri-Construksion” shpk & “Sireta 2F” shpk

NUIS K01725001F & NUIS K51501008J

Vlera e ofertës = **88,851,364.83** (tetëdhjetë e tetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “N.T.P Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj & “A.L - Asfalt” shpk

NUIS K91727010A & NUIS K81511508A

Vlera e ofertës = **91,708,336.6** (nëntëdhjetë e një milion e shtatëqind e tetë mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa TVSH.

8. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “S.M.O. Union” shpk & “Liqeni VII” sha

NUIS J66902042Q & NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **96,488,216** (nëntëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

9. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis-05” shpk & “Arifaj” shpk

NUIS K51518029B & NUIS J76418907K

Vlera e ofertës = **99,120,042** (nëntëdhjetë e nëntë milion e njëqind e njëzetë mijë e dyzetë e dy) lekë pa TVSH.

10. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Senka” shpk & “G.P.G Company” shpk

NUIS J94808405Q & NUIS J64324443V

Vlera e ofertës = **106,386,722** (njëqind e gjashtë milion e treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë e dy) lekë pa TVSH.

11. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk & “Ergi” shpk

NUIS K12911201C & NUIS K02727229P

Vlera e ofertës = **108,099,876** (njëqind e tetë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

12. Operatori ekonomik “4 A-M” shpk

NUIS K92005016L

Vlera e ofertës = **111,860,050** (njëqind e njëmbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:****1. Operatori ekonomik “Alb Tiefbau” shpk**

- Operatori ekonomik “Alb Tiefbau” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, pika 6, ku kerkohet qe:

“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt), diplomë, CV, librezat e punës si dhe të figurojnë në listpagesa për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë: 2 (dy) inxhinier Ndërtimi 1 (një) inxhinier Mjedisi ; 1 (një) inxhinier Mekanik ; 1 (një) inxhinier Topograf ; 1 (një) inxhinier Gjeolog ; 1 (një) Inxhinier Hidroteknik”.

Operatori ekonomik Alb Tiefbau Shpk nuk ka paraqitur diplomen per inxhinierin topograf te deklaruar Znj. Zhazeta Dajti. Nuk eshte paraqitur gjithashtu ne kundertimin me kerkesat e pikes 6 te Krieteve te Vecanta te Kuafikimit diploma per inxhinierin e ndertimit Sabahet Hysa.

- Operatori ekonomik nuk ploteson Kerkesat e Vecanta të DST, Kapaciteti Teknik, pika 2 ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:*

a) *Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

1. *Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me:*
2. *Kontratë*

3. *Situacionin përfundimtar;*
4. *Aktin e kolaudimit;*
5. *Certifikaten e marrjes ne dorezim.*

Operatori ekonomik ka paraqitur kontraten me Nr. 8337/6 Prot., date 01.04.2016 me objekt “Rikonstruksion i rruges Shkoder (mbikalimi i trenit) – Mes”, per te cilen nuk eshte paraqitur “Çertifikata e marrjes ne dorezim”, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.

- Referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve) të paraqitur nga Operatori ekonomik “Alb Tiefbau” shpk rezulton se ky Operator ka deklaruar se nëpërmjet Faturës së Shitjes Nr. 13 datë 20.10.2006 disponon Fadromë me goma 2 (dy) copë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara (Fadromë me goma), konstatoi se Operatori ekonomik “Alb Tiefbau” shpk nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e kërkuara sipas DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a” ku përcaktohet se: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi”*.
- Në këtë mënyrë, Operatori ekonomik nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.
- Sa më sipër Operatori ekonomik “Alb Tiefbau” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk

- Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar si Drejtues Teknik Z. Genc Xhafa. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues për Drejtuesin Teknik konstatoi se librezja e punës është kopje e pa noterizuar çka bie në kundërshtim me DST ku përcaktohet qartazi se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*
- Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar si pjesë të stafit teknik Ing. Ndërtimi Z. Genti Piga. KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues konstatoi se shoqëria “Alba Konstruksion” nuk ka paraqitur librezën e punës për Ing. e sipërcituar çka bie në kundërshti me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Operatori ekonomik ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Znj. Mimoza Spahiu. KVO pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjeken e deklaruar si më lart

konstatoi se nuk është paraqitur libreza e punës si dhe CV çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.

- Shoqëria “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon Autobot uji të montuar me targë TR 6681 N. KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e deklaruar konstatoi se Çertifikata e kontrollit teknik nuk është e vlefshme pasi i ka skaduar afati i vlefshmërisë më datë 04.08.2016. Data e hapjes së ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i segmentit të rrugës Mushqeta-Krrabë” ka qenë data 05.09.2016, çka bie në kundërshti me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma ”a”.
- Referuar Shtojcës 9, Shoqëria “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon një Autobot Naftë me targë AA823MP. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Siguracionin e mjetit (të vlefshme), çka bie në kundërshti me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma ”a”.
- Gjithashtu referuar Shtojcës 9, shoqëria “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Minieskavator çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku përcaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Minieskavatorë*”.
- Sa më sipër Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik, pasi nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, si dhe pika 16 gërma “a”. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ndregjoni” shpk & “Vllaznia Ndërtimi I.S” shpk

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ndregjoni” shpk & “Vllaznia Ndërtimi I.S” shpk ka deklaruar si Drejtues Teknik të punimeve Ing. Ndërtimi Z. Arben Çela. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për Drejtuesin Teknik konstatoi se Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur Diplomën për Ing. E sipërcituar çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4.
- Shoqëria “Ndregjoni” shpk ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Znj. Mandalina Allamani. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjekun e përgjithshëm konstatoi se nuk është paraqitur Urdhëri i mjekut çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Shoqëria “Vllaznia Ndërtimi I.S” shpk ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Z. Ilir Skenduli. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjekun e përgjithshëm konstatoi se nuk është paraqitur Urdhëri i mjekut çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Company Riviera 2008” shpk & “Dajti Park 2007” shpk

- Shoqëria Company Riviera 2008 shpk ne vertetimin e paraqitur nga Administrata Tatimore si dhe ne list pagesat per periudhen Janar 2015 – Qershor 2016, rezulton te kete nje numer mesatar prej **77 punonjesish**. Referuar Kontratës së Bashkpunimit me Nr. 10031 Rep. , Nr. 6249 Kol. të lidhur me date 02.09.2016 midis shoqërisë “Company Riviera 2008” shpk dhe “Dajti Park 2007” shpk ku shoqërite kane rene dakort qe perqindja e pjesmarrjes ne punë te jete si me poshte:

Company Riviera 2008 shpk – 95.2 %

Dajti Park 2007 shpk – 4.8 %

- Ne baze te Marreveshjes se Bashkpunimit si dhe referuar VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, Kreu VIII, Neni 74, pika 3 ku citohet se: *‘Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.’*, rezulton se shoqëria Company Riviera 2008 shpk duhet te kete nje numer mesatar prej **76 punonjesish** per realizimin e kontrates me sukses.Ndërkohë shoqëria Company Riviera 2008 shpk eshte shpallur fituese prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Tirane, per procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i rruges Shyqyri berxolli dhe Reshit Çollaku”** ku numri i punonjesve te kerkuar ka qënë **30 punonjes**. Pra rezulton se 30 punonjës të kësaj shoqërie janë të angazhuar në realizimin e objektit kontrates te lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tirane me Nr. 1866/8 Prot. datë 12.06.2015, punime të cilat ende nuk kanë përfunduar. Pra ne diference punonjesish me ata të angazhuar për realizimin e kontrates se lartpermendur, shoqërisë i ngelen vetëm **47 punonjës**.Numri mesatar i punonjesve te kerkuar për realizimin e objektit **“Rikonstruksioni i segmentit të rrugës “Mushqeta - Krrabë”** eshte **80 punonjes**.Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk zotëron kapacitetet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi pasi zotëron një numër mesatar prej **51 punonjës** duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, pika 4, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshua) si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VIII, Neni 74, pika 3 ku nder te tjera percaktohet se: *“.....kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje....”*.
- Shoqëria ”Company Riviera 2008” shpk ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Znj. Ilda Çikopana. KVO pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues konstatoi se mjeku i përgjithshëm nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit duke mosplotesuar në këtë mënyrë Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 7.
- Shoqëria ”Dajti Park 2007” shpk ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Z.Anastas Prifti. KVO pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues konstatoi se mjeku i

përgjithshëm nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit duke mos plotësuar në këtë mënyrë Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 7.

- Shoqëria “Company Riviera 2008” shpk ka deklaruar si drejtues teknik te punimeve në objekt Ing. Z. Ilir Kaçaku, te cilin me ane te deklarates per drejtuesin teknik e ka caktuar tashme si drejtues teknik të punimeve për objektin: **“Rikonstruksion i rruges Shyqyri berxolli dhe Reshit Çollaku”** ku është kualifikuar ne vend te pare nga Bashkia Tirane dhe per te cilin ka deklaruar se nuk do te jete i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete i pranishëm gjate gjithë kohes ne objekt duke mos plotësuar kështu Kriteret e Vecanta per Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 4, pjesë përbërëse e Dokumentave Standarte të Tenderit.
- Referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve) të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Company Riviera 2008” shpk & “Dajti Park 2007” shpk rezulton se ky Bashkim Operatorësh ka deklaruar se disponon Minieskavatorë 2 (dy) copë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara, konstatoi se mjeti me Nr. shasie 1259 i disponuar me anë të kontratës së Qirasë me Nr. 6370 Rep. ; Nr. 4010 Kol. datë 30.05.2014 referuar aktit të cdoganimit rezulton të jetë eskavator dhe jo minieskavator ashtu siç është deklaruar në Shtojcën 9. Në këtë mënyrë, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, pasi nuk disponon 2 (dy) minieskavatorë ashtu siç është kërkuar në DST, por faktikisht në bazë të dokumentacionit të paraqitur disponon vetëm 1 (një).
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Company Riviera 2008” shpk & “Dajti Park 2007” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Agri-Construksion” shpk & “Sireta 2F” shpk

- Referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve) të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Agri Construksion” shpk rezulton se ky Bashkim Operatorësh ka deklaruar se disponon Eskavator me zinxhir 5 (pesë) copë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara, konstatoi se mjeti tip Volvo me Nr. shasie Telaio-27244380 i disponuar me anë të kontratës së Blerjes me Nr. 11480 Rep. , datë 10.11.2008 referuar aktit të cdoganimit rezulton të jetë minieskavator dhe jo eskavator ashtu siç është deklaruar në Shtojcën 9 të shoqërisë “Sireta 2F” shpk. Gjithashtu KVO konstatoi se mjeti me Nr. Shasie S 160FU-5697 i disponuar me anë të kontratës së Blerjes me Nr. 5618 Rep. , datë 02.10.2008 referuar aktit të cdoganimit rezulton të jetë minieskavator dhe jo eskavator ashtu siç është deklaruar në Shtojcën 9 të shoqërisë “Sireta 2F” shpk.

- Në këtë mënyrë, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, pasi nuk disponon 4 (katër) Eskavator me zinxhirë ashtu siç është kërkuar në DST, por faktikisht në bazë të dokumentacionit të paraqitur disponon vetëm 3 (tre).
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “Agri Konstruksion” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.
- Shoqëria “Sireta 2F” shpk ka deklaruar si mjek të përgjithshëm Znj. Luiza Kolasi Zoto. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues për mjekun e përgjithshëm konstatoi se shoqëria “Sireta 2F” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për mjeken e sipërcituar çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.

6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “N.T.P Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj & “A.L-Asfalt” shpk

- Për të vërtetuar përvojën e mëparshme shoqëria “N.T.P Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj ka paraqitur si punë të ngjashme Kontratën me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Armath-Hamallaj Hidrovor”. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kjo shoqëri nuk ka paraqitur Aktin e kolaudimit për objektin e sipërcituar çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.
- Shoqëria “A.L-Asfalt” shpk ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Z. Nestor Mesuri. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues për mjekun e përgjithshëm konstatoi se Shoqëria “A.L.-Asfalt” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për mjekun e sipërcituar çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Shoqëria “A.L-Asfalt” shpk ka deklaruar si pjesë të stafit teknik Ing. Mjedisi Znj. Blerina Hoxha; Ing. Mekanik Z. Artur Ajazi; Ing. Topograf Z. Brian Osmanagaj dhe Ing. Gjeolog Z. Gëzim Tola. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik, konstatoi se shoqëria “A.L - Asfalt” shpk nuk ka paraqitur librezat e punës për inxhinierat e sipërcituar çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti Teknik, pika 6.
- Shoqëria “N.T.P Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar si pjesë të stafit teknik Ing. Mjedisi Znj. Ana Tomori; Ing. Mekanik Z. Pandeli Papa; Ing. Gjeolog Z. Çerçiz Durmishi dhe Ing. Hidroteknik Z. Sokol Bala. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik, konstatoi se inxhinierët e lartpërmendur nuk figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Për sa më lart Bashkimi i Operatorëve ekonomik “N.T.P Eurokos” Degë e shoqërisë së huaj & “A.L-Asfalt” shpk nuk disponon personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të

kontratës cka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 44 dhe Neni 46, pika 1 gërma ”b” ; si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 8/b.

7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “S.M.O. Union” shpk & “Liqeni VII” sha

- Shoqëria “Liqeni VII” sha ka deklaruar sipas Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve) se disponon: Fadromë me targë AA 883 BJ ; Autobot nafte me targë AA 365 IB; Autobetoniere me targë DR 1614 F; Kamion me targë DR 4225 E; Kamion me targë AA 928 IR; Kamion me targë DR 2919 D, por nuk ka paraqitur foto për mjetet e sipërcituara çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”.
- Shoqëria “S.M.O. Union” shpk ka deklaruar sipas Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve) se disponon: Rimorkiatorët me targa AC R 042 dhe SH 3739 E; Autobitumatriçe me targë TR 6291 R dhe Atobot Uji me targë SH 4365 E, por nuk ka paraqitur foto për mjetet e sipërcituara çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”.
- Shoqëria “S.M.O. Union” shpk ka deklaruar si pjesë të stafit teknik Ing. Gjeolog Z. Mehdi Shabani. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dokumentacionin shoqërues për Ing. E sipërcituar konstatoi se diploma është kopje e panoterizuar çka bie në kundërshtim me DST ku përcaktohet qartazi se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.”*
- Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik konstatoi se Shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për Ing. Gjeolog Z. Mehdi Shabani çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik konstatoi se Shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës si dhe CV për Ing. Ndërtim Z. Olger Pojani çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik konstatoi se Shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për Ing. Topograf Z. Hamid Culiqi çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik konstatoi se Shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për Ing. Hidroteknik Znj. Olta Metaliaj çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Gjithashtu Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Ing. Hidroteknik Znj. Olta Metaliaj nuk figuron në listpagesat e shoqërisë “S.M.O. Union” shpk çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik konstatoi se Shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për

Ing. Ndërtim Z. Fadil Burgaj çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.

- Shoqëria “Liqeni VII” sha ka deklaruar si mjek të përgjithshëm të shoqërisë Znj. Sofie Reka. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjekun e përgjithshëm konstatoi se marrëdhënia e punës e mjekes së sipërcituar me shoqërinë “Liqeni VII” sha nuk vërtetohet nga librezat e punës e paraqitur.
- Shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) mjek të përgjithshëm, por ka paraqitur një aktmarrëveshje të lidhur me një klinikë.
- Shoqëria “Liqeni VII” sha ka paraqitur një Deklaratë për Drejtuesin Teknik, por nuk ka përcaktuar se kush do të drejtojë punimet në objekt çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 4.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “S.M.O. Union” shpk & “Liqeni VII” sha nuk kanë paraqitur Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “e”.
- Gjithashtu Bashkimi i Operatorëve ekonomik “S.M.O. Union” shpk & “Liqeni VII” sha nuk kanë paraqitur Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “f”.
- Shoqëria “S.M.O. Union” shpk referuar QKR rezulton se ka një adresë të ushtrimit të aktivitetit të saj edhe në Tiranë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk ka paraqitur Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Bashkia Tiranë për vitin 2016, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 3.
- Shoqëria “S.M.O. Union” shpk referuar QKR rezulton se ka një adresë të ushtrimit të aktivitetit të saj edhe në Tiranë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “S.M.O. Union” shpk nuk ka paraqitur Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka kjo shoqëri e regjistruar në Shqipëri. Kjo Shoqëri ka paraqitur një Vërtetim që konfirmon e shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në Shkodër, por nuk ka paraqitur Vërtetim që konfirmon e shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike në Tiranë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “dh”.

8. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis-05” shpk & “Arifaj” shpk

- Shoqëria “Arifaj” shpk ka deklaruar sipas Shtojcës 9 se disponon Autobot Uji = Kamion me targa AA 207 GB + depozitë uji çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku është kërkuar që “*Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të disponojnë Autobot Uji 1 (një) copë*”.
- Gjithashtu referuar Shtojcës 9, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis-05” shpk & “Arifaj” shpk ka deklaruar se disponon 4 (katër) Eskavator me zinxhirë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për eskavatorët e deklaruar konstatoi se

Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, pasi nuk disponon 4 (katër) Eskavator me zinxhirë ashtu siç është kërkuar në DST, por faktikisht në bazë të dokumentacionit të paraqitur disponon vetëm 3 (tre).

- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Denis-05” shpk & “Arifaj” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

9. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Senka” shpk & “G.P.G Company” shpk

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor - teknik – ekonomik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se Bashkimi i Operatoreve “Senka” shpk & “G.P.G Company” shpk nuk permbush piken 16, kapaciteti teknik, të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi nuk disponon sasine e kërkuar të Kamion veteshkarkues minimum 15 ton.
- Referuar Shtojcës 9 (Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve) rezulton se Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk ka deklaruar se disponon Pajisje niveluese për nivelim shtresash çka bie në kundërshti me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16.
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Senka” shpk & “G.P.G Company” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

10. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk & “Ergi” shpk

- Shoqëria “Ergi” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) mjek të përgjithshëm çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Mjeku i përgjithshëm i deklaruar nga Shoqëria “Vëllezërit Hysa” shpk nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Gjithashtu Shoqëria “Vëllezërit Hysa” shpk nuk plotëson dokumentat e tenderit, Kriterete Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7, pasi nuk ka paraqitur librezën e punës për mjekun e përgjithshëm.
- Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk dhe “Ergi” shpk, nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar (dy) punonjes manovratore çka bie në

kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 44 dhe Neni 46, pika 1 gërma ”b” ; si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26 pika 8/b

- Gjithashtu Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk dhe “Ergi” shpk, nuk plotëson Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, pasi nuk disponon sasine e kerkuar te “Kamion veteshkarkues minimum 15 ton”.
- Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk & “Ergi” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

11. Operatori ekonomik “4 A-M” shpk

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor - teknik – ekonomik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se shoqëria “4 A- M” Shpk nuk permbush piken 16, te kriterete te vecanta te pranimit/kualifikimit pasi ka paraqitur dokumentacionin qe disponon vetem 1 (nje) vibrator betoni , ndërkohë që referuar DST, Kriteret e Vecanta të kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 përcaktohet se: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 2 (dy) vibrator betoni”.
- Shoqëria “4 A-M” shpk, nuk plotëson piken 16, te kriterete te vecanta te kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion (Leje qarkullimi, Çertifikaten e kontrollit teknik si dhe siguracion) per 2 fadromat e deklaruar sipas shtojces Nr. 9 .
- Shoqëria “4 A-M” shpk, nuk plotëson piken 16, te kriterete te vecanta te kualifikimit,per paraqitjen e mjeteve dhe paisjeve te mbrojtjes ne pune, pasi nuk ka dokumentuar qe disponon 1) Fikse zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra dhe 2) Prozhektore ndriçimi naten.
- Deklarata ne shtocjen Nr. 9 “Mbi disponimin e Makinerive”, eshte bere per nje objekt tjetër dhe jo për objektin “Rikonstruksion i segmentit te rruges “Mushqeta –Krrabe”.
- Sa më sipër Operatori ekonomik “4 A-M” shpk nuk ka kapacitetin e duhur teknik për objektin që prokurohet. Në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, referuar shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Gjoka Konstruksion” sha**, me adresë: **Njësia Nr. 5, Rruga “Dora D’Istria”, Hyrja 1 dhe Hyrja 2, Pasuria me Nr. 7/637 + 1 – N5, 7/637 + 2 – N1, Z.K 8270**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të

përgjithshme prej **85,133,640.6** (tetëdhjetë e pesë milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzetë pikë gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 30.09.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.